



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 209/12 Prot.

Tiranë, më 17/2/2017

Lënda : Për kërkesën për rishikim opiniononi

Drejtuar: Znj. Enkeleda SHEHI

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Adresa: Bulevardi "Dora D'Istria", nr.10

Tiranë

E nderuar znj. Shehi,

Paraprkisht ju bëjmë me dije se Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, është ligji specifik që parashikon parimet dhe detyrimet mbi përpunimin e të dhënave personale në çdo sektor dhe që është i detyrueshëm për t'u aplikuar në çdo rast përpunimi të dhënash personale që rrjedh nga çdo legjislacion sektorial dhe për përpunimet nga çdo kontrollues publik ose privat.

Një nga qëllimet kryesore të këtij ligji është edhe rregullimi/normimi i fushës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe veprimtarisë përpunuese nga kontrolluesit privatë dhe publikë, por në njëjtën kohë edhe përafrimi i legjislacioneve sektoriale (ligje dhe akte nënligjore) me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale të sanksionuara edhe në aktet komunitare (Direktiva 95/46, Konventa 108 e Këshillit të Evropës dhe së fundmi Rregullorja e re e BE-së/GDPR lidhur me mbrojtjen e të dhënave).

Pas vlerësimit të Ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" (neni 131), Zyra e Komisionerit konstaton se ka një parashikim të përgjithshëm lidhur me aksesin e AMF-së në të dhënat personale që përpunojnë kompanitë e sigurimit. Në këtë kuadër vlerësojmë se aksesin në të dhënat personale nuk mund të jetë i pakufizuar.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Rregullorja nr. 9, datë 25.01.2016 "Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjioneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e

miratimit të tyre nga Autoriteti” (Aneksi II), cituar nga ana juaj, bie në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave sanksionuar në nenin 5/c të ligjit Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AMF mund të aksesojë të dhënat personale të klientëve të kompanisë, por aksesit duhet të jetë i kufizuar nga qëllimi i përpunimit (rast pas rasti).

Në përfundim, duke vlerësuar bashkëpunimin midis institucioneve tona shprehim gatishmërinë për të dhënë asistencën tonë për çdo iniciativë në këtë drejtim për të realizuar qëllimin tonë të përbashkët, garantimin e sigurisë së të dhënave personale të shtetasve shqiptarë si një e drejtë dhe liri themelore e njeriut e garantuar në nenin 35 të Kushtetutës.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

